



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA
GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS RAHOVEC

Numri i lëndës: 2019:190097
Datë: 18.11.2022
Numri i dokumentit: 03663005

C.nr.351/2010

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtari **Betim Behluli**, në çështjen juridike të paditësve - A. K., S. K., B. K. si dhe G. K. që të gjithë nga fshati Xërxë, komuna e Rahovecit, S. K. dhe L. K. që të dyja nga Peja të cilët i përfaqëson përfaqësuesi i autorizuar avokati A. R. nga Gjakova si dhe R. K. nga Peja, kundër të paditurës Ndërmarrja Publike Infrastruktura e Hekurudhave të Kosovës – INFRAKOS SH.A., me seli në Fushë Kosovë, për shkak të vërtetimit të pronësisë, më 18.11.2022 merr këtë:

A K T V E N D I M

Padia e paditësve - A. K., S. K., B. K. si dhe G. K. që të gjithë nga fshati Xërxë, komuna e Rahovecit, S. K., L. K. si dhe R. K. që të gjithë nga Peja, kundër të paditurës Ndërmarrja Publike Infrastruktura e Hekurudhave të Kosovës – INFRAKOS SH.A., me seli në Fushë Kosovë **KONSIDEROHET E TËRHEQUR**, për shkak se nuk kanë vepruar sipas Aktvendimit të po kësaj gjykate prej datës 16.06.2022.

A r s y e t i m

Gjykata me Aktvendimin e kësaj gjykate të datës 16.06.2022, në seancën përgatitore, në kuptim të dispozitës së nenit 99 lidhur me nenin 102 të LPK-së, paditësve iu kthen padinë në plotësim dhe përmirësim me qëllim të angazhojnë avokat, dhe t'ia dorëzojnë gjykatës një kopje të autorizimit, në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktvendimi.

Gjykata vlerëson se palës paditëse i është dorëzuar aktvendimi konform nenit 112 të LPK-së dhe meqenëse palët paditëse brenda afatit të caktuar nga gjykata nuk e kanë plotësuar dhe përmirësuar padinë sipas aktvendimit të lartshënuar, andaj në pajtim me nenin 102.3 të LPK-së, gjykata padinë e paditësve e konsideron si të tërhequr.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA RAHOVEC,
C.nr.351/2010, më 18.11.2022

Gj y q t a r i
Betim Behluli

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditëve, nga dita e pranimit të këtij aktvendimi. Ankesa paraqitet nëpërmjet kësaj gjykate për gjykatën e Apelit në Prishtinë – Divizioni Civil.